



Ivanov nderon LSHPM-në

## Çmimi nderon 250.000 pensionistë

**Me rastin e shënimit të 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni më 16 shtator në Shkup është mbajtur Akademi solemne, në të cilën kryetari i shtetit, Gjorge Ivanov, LSHPM-së zyrtarisht i dhuroi formësimin e "Platformës së Republikës së Maqedonisë" për aktivitetet, unitetin dhe bashkësinë, për kontributi në zhvillimin dhe ndërtimin e vendit tonë gjatë shtatë dekadave**

Akademia solemne u mbajt në prezencë të rreth 700 pensionistëve dhe mysafirëve nga vendi dhe jashtë vendit të cilët me respekt, krenari dhe duartrokitje e përcollën fjalimin e njeriut të parë të vendit tonë. "Pensionistë të nderuar, të dashur mysafirë, zonja dhe zotërinj: Para një çerek shekulli, Republika e Maqedonisë shpalli

pavarësinë dhe sovranitetin. Pjesën më të madhe në atë përfshirje të madhe historike kanë gjeneratat të cilat kanë qenë të aftë për punë dhe të cilët në krahët e tyre, me punën, përvojën dhe diturinë e tyre kontribuuan në ndërtimin e shtetit të ri. Një pjesë e madhe e asaj gjenerate të rëndësishme tash më nuk janë të rinj, as të punësuar. Sot jam këtu me ju, në cilësinë e mbështetësit të ceremonisë së 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë. Posaçërisht jam i kënaqur që në akademinë e stome do të kem mundësinë që Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë ti ndajë Platformën e Republikës së Maqedonisë si falënderim për të gjitha aktivitetet e tyre në fushën e organizimit të pensionistëve. Pensionimi nga puna nuk do të thotë pensionim nga shoqëria. Përkundrazi, pensionistët me aktivitetet e tyre dhe ndihmën në kuadër të shtëpisë dhe familjes, por edhe të bashkësisë më të



gjërë, përmes pjesëmarrjes në iniciativa prej më të ndryshmeve me përvojën e tyre dhe kapacitetin e tyre intelektual janë pjesëmarrës aktiv të në rrjedhat shoqërore. E gjithë kjo në mënyrë të përshtatshme duhet maksimalisht të shfrytëzohet dhe verifikohet nga shoqëria jonë. "Platforma e Republikës së Maqedonisë" është mirënjohje për të gjithë pensionistët, për kontributin e tyre për shoqërinë gjatë kohës së punës, por edhe

pas daljes në pension. Por, njëkohësisht edhe pritje nga ju që të përcëni diturinë përvojën dhe mençurinë e juaj të akumuluar, pa të cilat asnjë shoqëri nuk mund të funksionojë. Me mendimin për mirëqenien e të gjithë qytetarëve tanë dhe për Republikën e Maqedonisë të fuqishme dhe prosperuese, më lejoni që në fund edhe një herë tu uroj jubileun e madh dhe tu dëshiroj ditë të lumtura dhe të përbushura pensionuese".

Pas fjalimit kryetari Ivanov në një atmosferë jashtëzakonisht solemne i dhuroi Platformën kryetarit të LSHPM Dragi Argirovski, i cili duke ju falënderuar mes tjerash tha:

"Në këtë rast solemn, më lejoni që fillimisht në emër të LSHPM dhe në emrin tim personal sinqerisht të falënderoj kryetarin e Republikës së Maqedonisë, D-r Gjorge Ivanov për dhurimin e platformës Lidhjes që do të thotë mirënjohje për 250 mijë pensionistë – anëtarë të një prej organizatave qytetare më masovike, më aktive, joqeveritare, jopolitike, multietnike në Republikën e Maqedonisë. "Platforma e Republikës së Maqedonisë" është mirënjohja më e lartë në historinë shtatëdekadëshe të organizimit të pensionistëve në vendin tonë. Kjo Platformë i nderon dhe respektton të gjithë pensionistët e vendit tonë. U lejoni që në fund edhe një herë tu uroj jubileun e madh dhe tu dëshiroj ditë të lumtura dhe të përbushura pensionuese".

panive të rëndësishme me të cilat bashkëpunojmë, të gjithë fituesve të pllaketave dhe mirënjohjeve jubilarë, pjesëmarrësve në programin e Akademisë solemne, anëtarëve të gardës së kryetarit, mysafirëve nga lidhjet e pensionistëve të Sllovenisë dhe Shqipërisë, mediave, të gjithë juve të cilët me prezencën e juaj keni rritur rëndësinë të këtij shënimi madhështor. Edhe në të ardhmen do të vazhdojmë të ecim rrugës të cilën kemi zgjedhur me përvojën, njohurinë dhe mençurinë tonë dhe në të cilën hapërojmë 7 dekada". Në sallë u dëgjuan duartrokitje të shoqëruara me gëzim dhe krenari. Të gjithë ishin të lumtur edhe për shkak të mirënjohjes, por edhe të vetëdijshëm se mirënjohja është edhe obligim për arritjen e rezultateve edhe më të larta dhe angazhim edhe më të madh për standard më të mirë dhe përbushje edhe më kualitative të ditëve të pensionistëve. Në kuadër të Akademisë u mbajt edhe një program kulturo-artistik.

### Olimpiada e pensionistëve "Radovish 2016"

## Ohri dhe Debërca për të gjashtën herë më të mirët



**Në një garë tepër të barabartë dhe konkurrencë të madhe, vendet e para në pjesëmarrje ekipore i morën SHP Ohër dhe Debërca – vendin e parë, SHP Prilep – vendin e dytë dhe SHP Tetovë – vendin e tretë**

Garuesit më të mirë nga lojërat sportive rajonale të shoqatave anëtare të LSHPM, më 3 shtator 2016 kanë garuar në 11 disiplina sportive në Olimpiadën republikane të pensionistëve e cila këtë vit është mbajtur në Radovish. Në këto gara sportive republikane të pranishmëve së pari iu drejtua kryetari i SHP Radovish Konçe Jordan Kostadinov i cili u dëshiroi garuesve rezultate të mira, ndërsa mysafirëve dhe tifozëve diskonim të kënd-

shëm. Të pranishmit i përsëriti edhe kryetari i Komunës së Radovishit, Sashko Nikollov.

Pastaj të pranishmëve iu drejtua kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, i cili mes tjerash theksoi se ky manifestim është edhe me rastin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve të Maqedonisë.

Lojërat për të hapura i shpalli Ministri plotësues i Punës dhe politikës sociale Dime Spasov i cili shprehu besimin se bashkëpunimi me LSHPM do të vazhdojë dhe uroi festën të gjithë pensionistëve të vendit tonë. Pastaj filluan garat. Në një garë tepër të barabartë dhe konkurrencë të madhe, vendet e para në pjesëmarrje ekipore i morën SHP Ohër dhe Debërca – vendin e parë, SHP Prilep – vendin e dytë dhe SHP Tetovë – vendin e tretë. Sipas disiplinave dhe kat-

egorive garuesit arritën rezultatet në vijim: Në fund të kampionatit u shpallën edhe sportistët më të mirë individual në tri disiplina: shenjëtari, shah dhe pikado në konkurrencën e femrave dhe të meshkujve. Epitetin më të mirë prej më të mirëve e merituan: Snezhana Millosheska (SHP Ohër) dhe Dragi Gacev (SHP Koçan) – shenjëtari, Liljana Sllavevska (SHP Qendër) dhe Aleksandar Stepanovski (SHP Manastir) – shah, Maria Stankoviç (SHP Solidarni penzioneri – llinden) dhe Cvetan Eftimovski (SHP Dellçevë) – pikado. Garat kanë përfunduar me dhurimin e trofeut në vijim për fituesit nga SHP Ohër dhe Debërca të cilëve për të gjashtën herë ua jep kryetari i LSHPM Dragi Argirovski. Pas këtij akti solemn vijuan shoqërimet me këngë dhe valle.

## Promovimi i librit

### "Argumentet ndriçojnë të vërtetën"

Më 26 gusht 2016 në sallën e stërmëshur të LSM, para mbi 200 adhuruesve të fjalës së shkruar, mes të cilëve ishin edhe Ministri i punës dhe politikës sociale Dime Spasov, kryetari i Komunës Gjorçe Petrov, Sokol Mitrovski, Lupço Ajdinski, kryetari i organizatës qytetare "Shkupjana Nëna Terezë" dhe mysafirë të tjerë është promovuar libri "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" nga Dragi Argirovski, gazetar dhe publicist i njohur. I pari për librin dhe autorin foli promotori Aleksandar Dimkovski kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës "Nova Makedonija".

"Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të ju drejtohem dhe të shfaqë një pjesë të pikëpamjeve të mia për problematikën e pensionistëve, me theks të veçantë të librit "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" të kryetarit të respektuar të LSHPM Dragi Argirovski. Ajo që ma hnitë tek pensionistët dhe duhet të jetë shembull për të gjithë është ndjenja e bashkësisë, unitetit dhe përkatësisë ndaj shtetit dhe patriotizmit të tyre gjeneratën e tretë, përkundër radhës së shembujve të ndarjeve në vijën sociale, politike ose partiake, për të cilat shpesh jemi dëshmitarë. Në numrin e madh të evenimenteve të cilat i organizojnë pensionistët, në mënyrë masovike marrin pjesë maqedonas, shqiptarë, serb, turq, vllëh,

romë... Shoqërohen, garojnë, zbavitën. Me një fjalë, i kënaqen jetës. Prandaj edhe nuk befason e dhëna nga libri "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" se LSHPM sot, në pikëpamje të pasurisë së përmbytjeve informative, të mundshme për anëtarësinë e saj, por edhe për të gjithë qytetarët, është shembulli i vetëm në Ballkan. Pastaj, të pranishmëve iu drejtua Kalina S. Andonova, kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse e gazetës "Penzioner Plus", recensent i librit edhe një prej promotorëve. Mes tjerash ajo tha: "Libri "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" nga Dragi Argirovski siç shihet nga vet titulli i kushtohet të vërtetës dhe gjurmimit të Argirovskit pas saj. Shumë libra janë shkruar jo që të besohet verbërisht në të shkruarën në ato, por ato janë shkruar që ti jepet lexuesit mundësinë që të mendojë për argumentet e shfaqura dhe nga e shkruara ta njeh të vërtetën. Umberto Eko ka thënë: "Nëse nuk ke çka të thuash, nuk duhesh të shkruash". Publicisti dhe gazetari, Dragi Argirovski me përvojën e tij të madhe ka çka të thotë, dhe prandaj shkruan. Dëshmi për këtë janë 20 librat e tij! Argirovski është një shkrimtar i mençur dhe i guximshëm me pikëpamje vizionare. Ai përmes mendimeve, fjalimeve dhe komenteve të tija, përmes analizave të tij me sukses ndriçon të vërtetën, duke

dhënë një serë argumente dhe fakte. Libri "Argumentet ndriçojnë të vërtetën" është kontribut personal i kryetarit Dragi Argirovski me rastin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni". Në promovim u prezantua edhe mendimi për librin, autorin dhe krijimtarinë e edhe të regjisorit dhe dramaturgut të nderuar, Branko Stavrev: Nga deti i informacioneve të përmbytura në 20 libra, Dragi Argirovski krijoi një studim sociologjik të llojit të vet që e përcjell në mënyrë complete dhe komplekse jetën e njeriut. Filozofia për "pleqërinë aktive" bëhet ide bazike – udhëheqëse e Argirovskit dhe ka të bëjë me synimin e tij të fortë që edhe më tutje të tregojë dhe dëshmojë se njeriu duhet të krijojë deri në frymë e tij të fundit. Mendimet dhe lëndat e tyre për autorin dhe krijimtarinë e tij kanë dhënë edhe Mendo Dimovski, Metodija Novkovski dhe Nijazi Xhelili. Në fund autori i librit Dragi Argirovski falënderoi të gjithë të pranishmit me fjalë të përzgjedhura falënderimi. Përshtypja e përgjithshme ishte se kjo është një prej promovimeve më të rralla në të cilën kanë marrë pjesë numër aq i madh i njerëzve. Libri, siç tha një prej të diskutuesve, është një libër i llojit të vet dhe mësues për gazetari humlues, por edhe për ndodhitë në LSHPM dhe më gjerë.